



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 315/3 prot.

Tiranë më 6.03.2019

REKOMANDIM

Nr. 19, datë 6.03.2019

PËR KONTROLLUESIN "SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.66 datë 22.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*", me objekt:

- Zbatimi i neneve 18 dhe 21 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*".

Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik autonom me statusin e një administrate shtetërore qendrore dhe funksionon nëpërmjet Zyrave Rajonale dhe Vendore të Punësimit si dhe Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional. Misioni i Shërbimit Kombëtar të Punësimit është ndjekja e politikave aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht. Në funksion të veprimtarisë së tij, kontrolluesi përpunon të dhënat për kategoritë e subjekteve "*punëmarrës*", "*aplikantë për punë*", "*vizitorë*" etj.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*", ka "*Njoftuar*" pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, megjithatë konstatohet se është i nevojshëm përditësimi i këtij "*Njoftimi*" sa i përket kategorive

“personi i kontaktit”, “kategoritë e subjekteve të të dhënave”, “kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, “qëllimi i përpunimit të të dhënave”, “marrësit e të dhënave” etj.

“Njoftimi” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, është i rëndësishëm pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, realizimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesit etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar: *“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji”.*

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur *“Politikën e Privatësisë”* në faqen zyrtare <http://www.shkp.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale. Informacioni i publikuar në *“Politikën e Privatësisë”*, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë *“Politikën e Privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online në internet.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mungesa e një rubrike të veçantë për *“Politikën e Privatësisë”* në faqen zyrtare të Kontrolluesit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim, sipas parashikimit të nenit 18 dhe të drejtat e parashikuara në Kreun IV *“Të drejtat e subjektit të të dhënave”*, të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cënuar ato.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr.9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar: *“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...”* dhe Vendimit nr. 6/2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*.

3. Kontrolluesi disponon faqen zyrtare www.puna.gov.al, qëllimi i të cilës është që të ndihmojë punë kërkuesit për tu integruar në tregun e punës dhe punë dhënësit për të plotësuar vendet e lira të punës, të ofruara prej tyre. Në këtë faqe, subjektet e të dhënave *“punë kërkues”* mund të aplikojnë duke dërguar jetëshkrimin e tyre

(Curriculum Vitae) ose të krijojnë një profil përdoruesi duke paraqitur paraprakisht të dhëna personale si: Numër identifikimi, emër, mbiemër, datëlindje, email, telefon, adresë, gjini dhe shtetësi. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave "punë kërkues" nëpërmjet "Politikës së Privatësisë" mbi rekrutimin, mbi fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, kohën e ruajtjes, transferimin e tyre ndaj palëve të treta etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 18, të ligjit dhe Udhëzimit nr.42/2014 "Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë".

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por kërkuan kohë për plotësimin e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 22, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit përditësimin e "Njoftimit" në lidhje me kategoritë "person i kontaktit", "kategoritë e subjekteve të të dhënave", "kategoritë e të dhënave personale që përpunohen", "qëllimi i përpunimit të të dhënave", "marrësit e të dhënave" etj.
2. Kontrolluesi "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet "Politikës së Privatësisë" në faqen zyrtare <http://www.shkp.gov.al>.
3. Kontrolluesi "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të informojë nëpërmjet politikës së privatësisë mbi rekrutimin, subjektet e të dhënave "punë kërkues" mbi mbi fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, kohën e ruajtjes, transferimin e tyre ndaj palëve të treta etj., në faqen zyrtare <http://www.puna.gov.al>.
4. Kontrolluesi "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni

dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.

5. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 6.03.2019.

KOMISIONERT

Besnik Dervishi

